

Ardiana Qamili, MA<sup>1</sup>  
Nazmije Shaqiri MA<sup>2</sup>

UDC: 327:911.3  
327:911.3(497)

## KONFLIKTET NDËRKOMBËTARE / LUFTA

## МЕЃУНАРОДНИ КОНФЛИКТИ / ВОЈНА

## INTERNATIONAL CONFLICTS / WAR

### **Abstract**

Unfortunately, armed conflicts and wars have continuously been part of human existence. Thus, history of human civilization cannot be fully constructed and understood without reckoning with the frequency, nature, catalysts and the aftermath of armed conflicts in many parts of the world throughout history.. Therefore, in this article we will discuss the local, regional and international disagreements which lead into full scale armed conflicts between states and nations. We also elaborate the core reasons that bring such conflicts, methods of their prevention and treatment throughout history, as well as we provide a few case-studies of such conflicts and the way they they were treated and dealt with.

Although The International humanitarian law has as its goal to limit the effects of such armed conflicts, it does not include a full definition of those situations which fall within its material field of application

As a conclusion, there is no doubt that in the modern democratic world, the role of international organizations in preventing armed conflicts is becoming increasingly necessary. This is so since, up until

---

<sup>1</sup> Autorja është candidate për doktoraturë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Fakulteti Juridik. E-mail: ardianaq@hotmail.com

<sup>2</sup> Autorja është candidate për doktoraturë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Fakulteti Juridik. E-mail nazmije.shaqiri@unite.edu.mk

now, diplomacy and diplomatic means, mainly through active negotiations, have been shown to be the most efficient way in preventing local, regional and global armed conflicts which are driven by political, nationalistic, economic, racial, religious and ideological catalysts.

## KONFLIKTI NDËRKOMBËTAR / LUFTA

### 1. Koncepti i luftës

Zhvillimi i luftërave daton shumë herët që nga kohërat e lashta, duke vazhduar në kohën e barbarizmit por edhe në kohën e qytetërimit të sotëm. Pra, që nga koha e primitivizmit, arsyeja e fillimit të luftës ishte lufta e mbijetesës të njeriut nga njeriu, mbijetesa e njeriut nga shtazët dhe anasjelltas. Më vonë luftërat janë zhvilluar në klane apo fise e deri te zhvillimi i luftërave shtet me shtet, si dhe luftërat civile. Nga kjo mund të themi që përmes përdorimit të fuqisë ushtarake apo nxitjes së luftës arrihen qëllime dhe interesa të ndryshme.

Deri në shekullin e XX, lufta konceptohej si fenomen patologjik, sepse lufta thuhej se paraqiste shkatërrimin por edhe keqfunksionimin e sistemit ndërkombëtar. Por, këto ishin mendime të gabuara për luftën shikuar nga konteksti i balancës së forcës.

Kjo ngase lufta është një shfaqje normale e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe pjesë normale e funksionimit të sistemit ndërkombëtar. Duke mos u lëshuar në kualifikimet ushtarake, apo më tepër teknike të luftës, që edhe nuk janë objekt i studimit tonë, do të përqendrohemi vetëm në eksplikimet teorike të luftës nga fusha e shkencave politike dhe në veçanti nga e drejta ndërkombëtare.

Brenda konceptonit politik të luftës, njëri nga përkufizimet tashmë tradicionale politike për luftën mbetet ai i Clauzewitzit, i njohur në thënien e tij të njohur se lufta është “*vazhdim i politikës me mjetet ushtarake*”.<sup>3</sup>

Kur flitet për luftën në të drejtën ndërkombëtare duhet bërë dallimin midis dy kategorive kryesore të luftës për nga shtrirja e saj territoriale, apo në raport me sovranitetin shtetëror edhe atë në:

- Luftërat ndër-shtetërore dhe
- Luftërat brenda-shtetërore (civile)

---

<sup>3</sup> Clauzewitz: “On war”, 1831

Lufta ndërshtetërore, apo ndryshe “ndërkombëtare”, është luftë që zhvillohet midis dy a më tepër shteteve sovrane.

Lufta brenda shtetërore apo civile, është lufta që zhvillohet brenda kufijve të një shteti dhe paraqet konfliktin e armatosur midis forcave të ndryshme politike të një vendi thjeshtë brenda forcave politike me qëllim të marrjes së pushtetit apo midis qytetarëve të të njëjtit shtet, por në bazë të dallimeve të qarta racore, kombëtare apo fetare.

Nëse flasim për luftën ndër-shtetërore, sipas Clauzewitzit, lufta është akt racional politik dhe i kontrolluar; akt i dhunës për ta mundur kundërshtarin dhe për ta nënshtruar atë vullnetit tonë. Pra lufta nuk është fundi i aktivitetit politik, por vazhdimi i politikës me mjete ushtarake.

• Prandaj, mund të thuhet se lufta bazohet në trilogjinë e faktorëve:

- Animizitetin; drejtuar kundër armiqve
- Menaxhimin e kontigjencisë; ku veçohet roli i ushtrisë dhe
- Qëllimet; objektivat e luftës

Morgenthau, ndërkaq përcaktonte 9 elemente që e bëjnë fuqinë e një shteti në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe atë: Pozita gjeografike, resurset natyrore, kapacitetet industriale, përgatitjet dhe aftësia ushtarake, popullata, karakteri kombëtar, karakteri moral, cilësia dhe aftësia diplomatike e tij si dhe aftësia dhe cilësia e qeverisë së atij shteti.<sup>4</sup>

## 2. Lufta në shekullin XX

Gjatë shekullin XX, mbizotëronte mendimi se lufta është akt legjitim i shtetit dhe ai kishte përkrahje të gjerë nga ana e juristëve ndërkombëtar, si një pjesë e doktrinës së sovranitetit.

Mirëpo më vonë, Konventa mbi Lidhjen e Kombeve 1919, Karta e OKB-së, 1945 dhe Karta e Londrës, me të cilën u krijua Tribunali mbi krimet e Luftës në Nyrnberg, vendosin një regjim të ri, sipas të cilit sipas të drejtës ndërkombëtare është legjitime vetëm në dy situata:

- Si akt i vetëmbrotjes
- Si akt i zbatimit të ligjit

Sipas këtij regjimi të ri, si legalisht ashtu edhe moralisht, mendimi i Clauzewitzit duket se po sfidohet. Sepse me luftë gjithnjë e më shumë pësojnë civilët, apo njerëzit e pafajshëm, njerëz të cilët nuk ishin pjesëmarrës në luftë.

<sup>4</sup> Morgenthau, Ibid. (1985)

Mirëpo, as në kushtet moderne, lufta nuk ka vetëm një funksion: aksionin ushtarak. Ajo siç po shihet po bëhet gjithnjë e më pak ushtarak dhe gjithnjë e më tepër politike, në çka Clauzewitzi dhe teoria e tij mbi luftën megjithatë nuk humb nga aktualiteti. Çka paraqiste lufta dhe si manifestohej ajo? Në shekullin XIX, lufta ishte një biznes formal: me okupimin ushtarak të territoreve; me observimin e sjelljes gjatë luftës; me deklarin formal të luftës së shek. XIX, vazhduan të praktikohehin, sado jo që në intensitetin e një shekulli më parë. Në fund të shekullit XX ndërkaq bota ishte dëshmitare të luftërave të tjera që dilnin nga korniza klasike për luftën.

### 3. Lufta në fillim të shekullit XXI

Është një fenomen tjetër i sulmit që nuk mund ta quajmë se kemi të bëjmë me luftë, por mund ta quajmë si fenomen i terrorizmit global. Pra fjalën e kemi te sulmet e 11 shtatorit ku SHBA-të ishin në luftë kundër terrorit, sepse Al-Kaeda, as nuk e shpalli formalisht luftën kundër SHBA-se; ajo as nuk ishte shtet që inicoi luftën, por një entitet jo-shtetëror; dhe në sulmin e 11 shtatorit kundër SHBA-ve, pati një sulm kundër një shteti sovran, por jo edhe okupim të tij territorial, siç kishte ndodhur gjatë luftërave të shekujve: XIX dhe XX. Ngjarjet e 11 shtatorit vetëm e përmbyllen “luftën e shenjtë” të paralajmëruar kundër SHBA-ve, (por jo të shpallur formalisht) të Osama bin Ladenit, që në vitin 1996. Se sa është kjo luftë në kuptimin e plotë të fjalës, ende nuk është e qartë.

Brenda kontekstit të luftës së ftohtë, SHBA-të për t’iu revanshuar ish-BRSS dhe mbështetjes së tij për Vietnamin Verior, menjëherë pas pushtimit sovjetik të Afganistanit në dhjetor të vitit 1979, CIA, përmes shërbimit sekret pakistanez, mbështeti luftërat afgan, (fillimisht me nga 20-30 milionë dollarë, kurse në vitet e fundit edhe me nga 3 bilionë dollarë)<sup>5</sup>. Arma e cila përfundoi luftën në Afganistan: “*stinger*”, me të cilën afganët rrëzuan 269 aeroplanë dhe helikopterë sovjetik, pas përfundimit të luftës mbeti jashtë kontrollit dhe shumë autorë perëndimor, madje konsiderojnë se filloi t’i kthehet si bumerang SHBA-së, në duart e talebanëve të rebeluar dhe më pas të Al-Kaedës. Brenda këtij konteksti të luftës së ftohtë, ngjashëm kishin vepruar edhe sovjetikët dhe kinëzët duke e armatosur Vietnamin në luftën e tyre kundër SHBA-ve.<sup>6</sup>

<sup>5</sup> Shih per kete: Peter Bergen: “Holly War”, (2002)

<sup>6</sup> James Lee Ray-“ American Foreign Policy and political ambition “. Copyright C 2008 CQ, Advision of Congressional Quarterly Inc. f. 173-175

Brenda dhjetë viteve të fundit në kalimin nga shekulli XX në XXI, këto zhvillime të reja në rrafshin e luftës u manifestuan edhe në ndryshime krejtësisht të ndryshme në raport me opinionin publik. Për dallim nga raportet e vonuara të luftës, në fund të shekullit XIX dhe fillimin e shekullit XX, apo raportimit post-festum në radio dhe televizion nga krizat e luftës, gjatë viteve 60-80, dekada e fundit e shekullit XX ndryshuan edhe mediat në relacion me luftën. Intervenimi i NATO-s në vitin 1999, kundër çaqeve serbe ishte transmetim direkt përmes televizioneve i aksionit më të madh dhe më të gjatë ushtarak nga ajri; po kështu sulmi terrorist i 11 shtatorit u transmetua direkt përmes televizionit si i pari transmetim i drejtpërdrejt i një sulmi më të madh terrorist.<sup>7</sup> Ky dimension i publicitetit të luftës, sipas disa autoreve ishte i rëndësishëm për të fituar legjitimitetin e brendshëm, si dhe për të shkelur armikun.

Të gjitha këto zhvillime të reja në këto dhjetë vitet e fundit sikur shtruan nevojën për një diskurs të ri teorik për luftën, sipas te cilit, nga ajo që u tha më lartë del se ky tip i ri i luftës do të mund të përmbledhte këto karakteristika në vijim:

- Këto luftime janë më shumë një hap drejt arritjes së qëllimit të fundit se sa arritja e qëllimit përfundimtar me mjete luftarë;
- Këto luftime përfshijnë përdorimin e forcës si në fushëbetejë, ashtu edhe jashtë saj;
- Synimi i këtyre luftimeve të reja është që të arrijnë efektet maksimale me humbje minimale;
- Këto luftime kane përcjellje dhe mbulim medial.<sup>8</sup>

## ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE NDËRKOMBËTARE

### 1. Shtruarja e problemit

Në shqyrtimet e gjertanishme u fol për kuptimin e së drejtës ndërkombëtare dhe për pasojat e saj në: njerëz dhe në shkatërrime materiale.

<sup>7</sup> Shih për këtë më tepër në: "Media at War", 1993; W.Clark: "Waging modern war", (2001); Peter Bergen: "Holly war", (2002); Bob Woodward: "Bush at war", New York, 2002, etj.

<sup>8</sup> Shih për këtë edhe: Martin Woollacott: "What is it good for?", "The Guardian", London, 12 November 2005, ribotuar edhe në: "Bosnia Report", No.49-50, December- march 2006, p. 45;

Për t'u parandaluar të gjitha këto pasoja në doktrinën e së drejtës ndërkombëtare është ngritur një drejtim i veçantë që ka të bëjë me:

- Parandalimin dhe
- Zgjidhjen e konfliktit.

Pos në planin akademik edhe në marrëdhëniet reale ndërkombëtare, jo vetëm tash por së paku që nga shekulli XVIII, sidomos nga Britania e Madhe ishte ngritur doktrina e balancit të forcës, si preventive e luftërave të reja.

Mirëpo lufta e parë botërore dëshmoi për dështimin e këtij sistemi preventiv, kurse lufta e dytë botërore edhe më tepër.

Pas luftës së parë botërore u tentua që të krijohet një sistem i sigurisë botërore përmes Lidhjes së Kombeve, por siç u pa edhe ky dështoi me fillimin e Luftës së II Botërore. Pas Luftës së II Botërore në kuadër të OKB-së u ngrit një sistem i ri i sigurisë kolektive i bazuar në kartën e OKB-së dhe i implementuar përmes Këshillit të Sigurimit si institucion kyç për ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Ky sistem i sigurisë kolektive i OKB-së bazohet në përgjegjësinë primare të pesë anëtarëve të përhershëm: SHBA, Kina, Rusia, Britania e Madhe dhe Franca.

Kemi parë se sistemi ndërkombëtar karakterizohet në një shkallë të lartë nga konfliktet dhe lufta për pushtet midis shteteve sovrane. Gjithashtu, aktorë të tjerë, si: grupe etnike, dhe organizata, luftojnë për këmbëngulje për interesat dhe idealet e tyre.

Në paktin e OKB-së thuhet: *“Të gjithë anëtarët duhet t'i zgjedhin mosmarrëveshjet e tyre ndërkombëtare me mjete paqësore, në mënyrë të tillë që paqja, siguria dhe drejtësia në botë të mos vihen në rrezik.”*

Megjithatë, konfliktet dhe përleshjet e dhunshme janë një tendencë që bie lehtë në sy në pamjet e lajmeve. Ka të ngjarë që të ketë lidhje me një anë të rëndësishme të sistemit ndërkombëtar, mungesën e një autoriteti të lartë dhe rregullave të njohura, që duhet të respektohen nga të gjithë. Në një bashkësi ndërkombëtare të tillë anarkike, rreziku është shumë më i madh, sesa brenda një shteti, që konflikti të zhvillohet me ballafaqim force dhe përdorim dhune.

Megjithatë, duket se konfliktet në të cilat janë shtete dhe grupe etnike, normalisht janë në një nivel *“të ulët”*, pa të vrarë dhe të plagosur. Ka edhe një varg konfliktesh me të vrarë dhe të plagosur, që zakonisht nuk quhet luftë, si, për shembull, konflikti midis turqve dhe kurdëve në Turqi. Në fund kemi konfliktet që quhen luftë, ku numri i të vdekurve arrin të paktën 1000 gjatë një viti dhe ku konflikti zgjat për një kohë të caktuar, si, për shembull lufta midis Eritrese dhe Etiopisë në

mbarim të viteve '90, që ka kërkuar jetën e disa mijërave njerëzve. Shumë konflikte janë kundërshtim, që ziejnë nga brenda dhe është e vështirë që t'i dallosh para se të shpërthejnë në kacafytje të dhunshme.

## 2. Shkaqet për paraqitjen e konfliktit

Po t'u futemi thellë shkaqeve për luftë dhe konflikt, janë aq të shumta, sa edhe numri i konflikteve në botë. Në vija të trasha themi se këto janë llojet kryesore të konflikteve:

- Luftëra rajonale
- Konflikte etnike
- Konflikte ekonomike
- Konflikte fetare dhe ideologjike

Luftërat e mëdha në histori janë bazuar në luftërat rajonale. Gjermania, Franca, Rusia, Anglia dhe Spanja, për shembull, kanë pasur luftëra të mëdha, shekullin e kaluar, me miliona të vdekur, si rezultat. Në Azinë Lindore dhe Juglindore janë zhvilluar dhe zhvillohen luftëra të ngjashme midis vendeve të mëdha dhe të vogla, si Kina kundër Japonisë, Koreja e Veriut dhe Koreja e Jugut, Rusia kundër Kinës dhe Japonia kundër Ruisë. Në Lindjen e Mesme ka qenë dhe vazhdon të ekzistojë konflikti mes Izraelit dhe vendeve arabe si dhe midis vet vendeve arabe.

Konfliktet etnike janë ato konflikte ku grupet etnike qëndrojnë kundër njëri-tjetrit. Ndoshta me i tmerrshmi i konflikteve në vitet 90 ishte ai ndërmjet tuci-ve dhe hutu-ve në Ruandë, në vitet 1993-94, ku brenda një kohe të shkurtër u vranë më shumë se 800.000 njerëz. Edhe Evropa ka pasur konfliktet e saj etnike, në kohën e shpërndarjes së ish-Jugosllavisë, me dhjetëra mijë të vrarë.

Lufta për burime quhet shpesh konflikt ekonomik. Konfliktet lindin, për shembull, për ujin, për naftën ose për peshkun. Kur Iraku sulmoi dhe pushtoi Kuvajtin, në vitin 1990, në radhë të parë ishin burimet e naftës shkaku kryesor. Në Lindjen e Mesme uji është një burim i rëndësishëm dhe i vazhdueshëm konflikti, për shembull, midis Turqisë dhe shteteve fqinje në jug të vendit si dhe midis libanezëve dhe irlandezëve. Edhe Norvegjia ka pasur mosmarrëveshje të përsëritura me fqinjët e saj për burimet e peshkut. Ndoshta konflikti më i njohur fetar në Evropë është ai midis katolikëve dhe protestantëve në Irlandën e Veriut. Mirëpo, në shumë vende të botës mund të gjejmë një radhë shembujsh të këtij lloji konflikti, si në Indi midis myslimanëve dhe hindu-ve dhe në

Filipine, midis krishterëve dhe myslimanëve. Lufta e Ftohtë midis superfuqive, Bashkimit Sovjetik dhe SHBA-ve, nga shumë anë, ishte një konflikt ideologjik: komunizmi kundër kapitalizmit. Mirëpo, konfliktet rrallë, ose më mirë të themi, kurrë nuk janë ky ose ai tip. Ato huazojnë tendenca nga njëri-tjetri, që i kthejnë në konflikte vlerash dhe interesi. Konfliktet etnike, si konfliktet midis tuci-ve dhe hutu-ve, kanë të bëjnë jo vetëm me ndryshimin midis kulturave, por edhe me fakte se kush do ta drejtojë bashkësinë dhe bashkë me të mundësinë për ti dhënë përparësi grupit të vet. Konflikti fetar në Irlandën e Veriut ka të bëjë shumë me dallimet ekonomike midis protestantëve, që ndjejnë një lloj përkatësie të Britania e Madhe e pasur dhe katolikeve, që janë të lidhur tradicionalisht me Irlandën e varfër. Luftërat rajonale janë gjithashtu në një shkallë të lartë konflikte ekonomike, që kanë të bëjnë me kontrollin e territoreve dhe të burimeve.

### 3. Trajtimi dhe zgjidhja e konflikteve<sup>9</sup>

#### 3.1. Fazat dhe masat

Të gjesh një zgjidhje përfundimtare për një konflikt, një zgjidhje me të cilën mund të jetojnë të dy palët, shpesh është shumë e vështirë. Në shumë raste, bashkësia ndërkombëtare duhet të kujdeset që në radhë të parë konflikti të mos kthehet në dhunë dhe dhuna të mos përhapet në vendet fqinje etj. Për këtë, një palë e tretë, që nuk është angazhuar drejtpërsëdrejti në konflikt, shpesh duhet të përqendrohet në uljen e tensioneve, megjithatë mund të japë ndihmesë në hedhjen e themelit për një zgjidhje përfundimtare të konfliktit.

Masat duhen të merren, varen nga një radhë raportesh dhe nga faza në të cilën ndodhet konflikti. Një konflikt mund ta ndajmë në tri faza: para përdorimit të dhunës, gjatë përdorimit të dhunës dhe pas përdorimit të dhunës. Kur Bosnja doli nga ish-Jugosllavia, në vitin 1991, nuk shkoi shumë kohë dhe udhëheqësit e pakicës serbe kaluan në kundërshtim të armatosur, të mbështetur mirë nga vendi fqinj, Serbia. Shpejt Bosnja u shkatërrua nga një luftë civile e përgjakshme.<sup>10</sup> Pas një radhë sulmesh dhe kërcënimesh nga NATO-ja, në vitin 1995, më në fund, serbët i pushuan veprimet luftarake. Gjatë gjithë këtij konflikti,

<sup>9</sup> Shih më tepër: Kval – Mellbye – Tranøy: Politika dhe demokracia, Prishtinë 2005, f. 147 – 155.

<sup>10</sup> David Chandler - "Bosnia Faking Democracy after Dayton". Second edition PLuto Press, 2000, f. 86



prej intensifikimit të tij, gjatë përdorimit të dhunës dhe kohën pas saj, u zbatua një spektër i gjerë masash. Shumë njerëz mbeten të befasuar për papajtueshmërinë me të cilën u zhvillua kjo luftë. Asnjë mase nuk pati dobi, derisa u futen avionët e huaj gjuajtës. Më vonë u diskutua në mënyrë të veçantë brenda OKB-së se si mund të veprohej ndryshe pa marrë një përgjigje të qartë. Sot serbet kanë një vetëqeverisje të pjesshme në një pjesë të Bosnjës. Aty është vendosur një formë qeverisjeje. Nëse kjo është një zgjidhje e përhershme, apo konflikti ka pushuar vetëm përkohësisht, është shpejt që të thuhet. Marrëdhëniet midis grupeve të popullsisë vazhdojnë të karakterizohen nga mosbesimi dhe akuzat.

### ***3.2. Mjetet diplomatike për të dal nga konflikti***

Gjatë periudhave të ndryshme në suaza të komunitetit ndërkombëtar janë bërë përpjekje për të eliminuar apo zbutur shkaqet që çojnë deri në konflikte ndërkombëtare në ndërkohë që të ngrihen mjete për zgjidhjen e tyre afatgjatë. Si rezultat i këtyre tentativave u krijuan lidhjet e kombeve dhe OKB-ja.

E drejta ndërkombëtare klasike mjetet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve i ndan në dy kategori mjete paqësore dhe detyruese për të mos e përjashtuar edhe mundësinë e luftës, ndërkaq rendi ndërkombëtar bashkëkohor e ndalon luftën si metodë për të zgjidhur problemet ndërmjet shteteve. Metodatat paqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet shteteve ndahen në: diplomatike dhe gjyqësore.

Si mjete diplomatike për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve janë:

- Negociatat e drejtpërdrejta;
- Shërbimet e mira;
- Ndërmjetësimi;
- Pajtimi dhe
- Komisionet hetuese.<sup>11</sup>

Mjeti i parë dhe më i shpeshtë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve janë negociatat diplomatike të cilat mbahen mes palëve që janë të involvuar në konflikt. Mangësia e vetme e negociatave diplomatike është se në të kyçen vetëm palët e involvuara në konflikt të përfaqësuar përmes përfaqësuesve të tyre diplomatik, gjë që u mungon objektiviteti.

<sup>11</sup> Abdulla Azizi, Elena Andreevska "Bazat e së drejtës ndërkombëtare publike", Shkup, 2008, f.238

Shërbimet e mira dhe ndërmjetësimi janë metoda tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në të cilën pala e tretë, më tepër shtete apo organizata ndërkombëtare përpiqen që ti shtyjnë palë në konflikt që të vazhdojnë negociatat ose të pajtohen që të gjejnë mënyrë për tejkalimin e situatës së mosmarrëveshjes.

Metoda tjetër për tejkalimin e mosmarrëveshjeve është edhe komisioni hetues dhe pajtimi. Institucioni hetues është relativisht i ri dhe rregullat e funksionimit të tij janë sjellë në Konferencën e parë paqësore të Hagës në vitin 1899<sup>12</sup> ndërsa janë plotësuar në Konferencën e dytë në vitin 1907. Neni 9 i Konventës parasheh mundësinë që në qoftë se palët në konflikt nuk arrijnë zgjidhje diplomatike të formojnë të formojnë komision hetues qëllimi i të cilit do të ishte që përmes hetimit të drejtë të vijnë deri tek situata faktike.

Pajtimi dallon nga komisioni hetues nga ajo që bëhet fjalë për hulumtim të gjithanshëm të mosmarrëveshjes ana e një trupi e cili e gëzon besimin e plotë të palëve në konflikt dhe tenton të sjell deri në qëndrimet e kundërshtuara dhe të arrin zgjidhje të pranueshme.

## Conclusion

Many authors think that the UN itself serves as a deterrent to conflict. The organization promotes dialogue and cooperation between nations and countries of the world. Moreover, it actively participates in the development of international laws and regulations. Also, the efforts that this organization is offering to the development of poor countries around the World is one of the measures for long term prevention of conflicts. This is so since poverty paves the way for disappointment and lack of stability, hence as a result of armed struggles that have long term consequences for several countries involved in it. From the perspective of a single individual, the failure to ensure basic life needs to keep yourself and your family alive, such as demand for food, basic material goods, for security and hope for a better future, etc., results in the individuals thinking that if they have nothing or little to lose and much to gain if they enter an armed struggle, then they should do so, so as to fulfill their basic life demands, needs and objectives.

Globalization, and to the same extend the trade growth between the countries of the world, has led to an increased dependence of those

---

<sup>12</sup> Hague Convention I (29 July 1899), Convention for the Pacific Settlement of International Disputes, Entry into Force 4 September 1900.

countries from each other. Is it the case that today most states avoid military confrontation because the costs of such wars would simply be huge? This may be one of the explanations why a war between former adversaries, such as France and Germany, today is totally out of consideration. On the other hand, there are scholars who claim that globalization and trade deepen the distinction between poor and rich states as well as between population groups and, thus, are in themselves embryos of future armed conflicts and social turmoils.

States with democratic forms of government do not tend to fight each other. In other words, the form of government itself can decide the level of conflict, both within the state and between states.

**Recensentë:**

**Prof. dr. Afrim Osmani**

**Prof. dr. Jusuf Zejneli**

**Literatura:**

1. Carl Clausewitz, - "On war". Penguin books Limited, 2003.
2. Peter Bergen- Holly War, Inc: Inside the secret world of Osama bin Laden, 2002
3. Rupert Smith- The Utility of Force: The Art of War in the Modern World, Penguin Books Limited, 2012
4. Martin Shaw- "The new western way of war: Risk - Transfer War and its Crisis in Iraq", Publisher: Polity, 2005
5. James Lee Ray- "American Foreign Policy and political ambition". Copyright C 2008. Avdision of Congressional Quarterly Inc.
6. Bob Woodward- "Bush at War". Simon & Schuster Rockefeller Center, New York 2002
7. Kval – Mellbye – Tranøy: "Politika dhe demokracia", Botues-Rozafa, Prishtinë 2005
8. Abdulla Azizi, Elena Andreevska "Bazat e së drejtës ndërkombëtare publike", Shkup, 2008.
9. David Chandler- "Bosnia Faking Democracy after Dayton". Second edition. Pluto Press, 2000
10. Blerim Reka, Bardhok Bashota, Ylber Sela, "Marrëdhëniet Ndërkombëtare". Botues Instituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtare. Shkup, 2016.